



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

VENDIM
Nr. 334, datë 28.07.2021

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN
ADMINISTRATIVE TË APELIT, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR. 290, DATË 06.07.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e relatorit si më poshtë:
 1. Për kandidaten znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu.
3. Afati për dorëzimin e deklaratës së pasurisë dhe të interesave privatë nga kandidatja znj. {...} është deri më datë 08.09.2021.
4. Për kandidatët znj. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, procedurat e verifikimit të kritereve të kandidimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Për kandidatin z. {...}, i cili ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, procedura e verifikimit të kriterëve të kandidimit që ka përfunduar për këtë kandidim, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
6. Për kandidaten znj. {...} e cila ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që ka përfunduar për këto kandidime, është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR